



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

Rregullore
Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Taksa, Ngarkesa
dhe Gjoba Komunale, 01. nr. 016-122568 e dt. 29.12.2015

Gjilan, mars 2016

Në bazë të nenit 12.2 pika c), të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen e Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 të datës 4 qershor 2008) dhe nenit 38 paragrafi 1.3 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 016-126211 të dt. 06.11.2014 dhe në zbatim të dispozitave të kreut I dhe II të Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 27 e datës 03.06.2008), Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në mbledhjen e mbajtur më datën 31.03.2016, miraton:

RREGULLOREN
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR TAKSA, NGARKESA
DHE GJOBA KOMUNALE, 01. NR. 016-122568 E DT. 29.12.2015

Neni 1

1. Te neni 11 i rregullores bazë: pas tarifës 7 shtohet titulli me këtë përmbajtje: “Tarifat për shërbimet që ofrohen për shfrytëzimin e stadiumit ndihmës të qytetit dhe fushës sportive në dardani nga shkollat e regjistruara të futbollit, nga qytetarët dhe klubet sportive jashtë komunës” dhe tarifa 8 sipas radhës me këtë përmbajtje:

Tarifat:

8.1. për stërvitje të shkollave të futbollit	30€/1.5 orë
8.2. për lojë futbollit për tri grup moshat	50€/3 orë
8.3. shfrytëzimi i stazës (trakes) se atletikës nga qytetarët	5€/mujore
8.4. stërvitja nga shkollat e futbollit me reflektor tarifë shtesë	10€
8.5. për lojë miqësore me klube jashtë qytetit	50€
8.6. për lojë futbollit në terrenin sportiv në Dardani	8€/1orë
8.7. për lojë futbollit në terrenin sportiv në Dardani me reflektor	12€/1orë

2. Nga tarifat 8.1, 8.2 dhe 8.4 lirohen klubet e futbollit senior dhe junior.

3. Te neni 11 i rregullores bazë: pas tarifës 8 shtohet titulli me këtë përmbajtje: “Tarifat për shërbimet që ofrohen për shfrytëzimin e hapësirave të shtëpisë së rinisë nga qytetarët, OJQ-të, Organizatat tjera dhe institucionet” dhe tarifa 9 sipas radhës me këtë përmbajtje:

Tarifat:

9.1. shfrytëzimi i sallave për secilën veç e veç	45€/3 orë
9.2. shfrytëzimi i amfiteatrit	50€/2 orë
9.3. Shfrytëzimi i sallës së konferencave	50€/2 orë

Neni 2

Pas miratimit të ndryshimeve dhe plotësimeve në rregulloren bazë, bëhet teksti i spastruar i rregullores bazë.

Neni 3

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen e Komunës.

01. nr. 016-30397
Gjilan, më 31.03.2016

Kryesuesja e Kuvendit

Valentina Bunjaku Rexhepi

